

FLUAZINOVA[®] PLUS

PRODUKT PER MBROJTJEN E BIMEVE

**FUNGICID PER KONTROLLIN E KROMES MOLLE, NJOLLOSJA KAFE NE DARDHE,
KALBEZIMI NE HARDHI, VRUGUT NE PATATE.**

Lënda vepruese: *Fluazinam i pastër: 40.97g (= 500 g/L)*
(Përmban 1,2-benzizotiazolin-3-one dhe Fosfat eter polioksietilenetridecil)
Formulimi: *Suspension i koncentruar (SC)*



RREZIK !

“Lexo fletëudhëzuesin para përdorimit”

INFORMACION PËR RREZIKUN:

H315 Shkakton irritim të lëkurës.
H317 Mund të shkaktojë një reaksion alergjik në lëkurë.
H318 Shkakton dëmtime serioze të syve.
H361d Dyshohet se dëmton fëmijën e palindur.
H410 Shumë toksik për gjallesat ujore me efekte afatgjata.

INFORMACION SHITESË PËR RREZIKUN:

EUH401 Për të shmangur rreziqet për shëndetin e njeriut dhe mjedisin, zbatoni udhëzimet për përdorim.
EUH210 Fletë informuese të sigurisë në dispozicion me kërkesë.

INFORMACION PËR MASAT PARANDALUESE:

P102 Mbani jashtë arritjes së fëmijëve.
P202 Mos e trajtoni deri sa të jenë lexuar dhe kuptuar të gjitha masat e sigurisë.
P280 Vishni dorashka mbrojtëse/veshje mbrojtëse/mbrojtje për sytë/mbrojtje për fytyrën/mbrojtje të dëgjimit.
P308+313 NËSE ekspozohet ose ka shqetësime: Kërkoni këshillë/ndihmë mjekësore.
P333+313 Nëse ndodhin irritim të lëkurës ose lëkurë e irrituar: Kërkoni këshillë/ndihmë mjekësore.
P302+352 - NËSE NË LËKURË: Lani me shumë ujë.
P501 Hidhni përmbajtjen/enën në përputhje me rregullat aktuale mbi mbetjet e rrezikshme.

KËRKESAT SHITESË:

Kur përgatitni përzierjen, vishni dorashka dhe maska filtrimi. Përgatitni përzierjen në enë speciale, mundësisht në ambiente të jashtme ose në dhoma të ajrosura mirë, jo në ato që përdoren për punë të tjera bujqësore, si psh magazinim i ushqimeve për kafshë. Mos e përdorni produktin afër rrjedhave të ujit. Mos e ndotni ujin me produktin ose kontenitorin e tij. Mos e pastroni pajisjet e spërkatjes afër ujërave sipërfaqësore. Shmangni ndotjen përmes sistemeve të drenazhit të ujit nga fermat dhe rrugët. Aplikimet në hardhi, mollë dhe dardhë, duhet të kryhen me spërkatëse të pajisura me sprucatorë cilësorë.
Ndërhyrjet në pemët e mollës dhe dardhës (p.sh. hollimi i frutave) duhet të kryhen me përdorimin e dorashkave dhe jo para se të kalojnë 24 ditë nga trajtimi i fundit.

Ndërhyrjet në hardhi duhet të kryhen me përdorimin e dorashkave dhe jo para se të kalojnë 10.5 ditë nga trajtimi i fundit.

Respektoni një zonë të paprekur prej 15 metrash nga zonat jo bujqësore kur trajtoni hardhitë, mollët dhe dardhët.

Spe3 Për të mbrojtur organizmat ujorë, respektoni një zonë të paprekur prej 20 metrash (duke përfshirë 20 metra brez

të mbuluar me bimësi) nga ujërat sipërfaqësorë kur trajtoni hardhitë, mollët dhe dardhët.

Spe3 Për të mbrojtur organizmat ujorë, respektoni një brez të paprekur prej 10 metrash (duke përfshirë 10 metra brez të mbuluar me bimësi) nga ujërat sipërfaqësorë kur trajtoni patatet.

INFORMACION PËR MJEKUN

Simptomat: irrituese për lëkurën dhe sytë; irrituese për mukozën e sistemit frymëmarrës.

Terapia: simptomatike.

Kërcënimet: Nëse aksidentalisht është gëlltitur, pini 1-2 gota ujë dhe shkaktoni të vjella nëse personi është i vetëdijshëm; mos shkaktoni të vjella ose jepni asgjë me gojë nëse personi është në gjendje të paqartë.

Paralajmërim: Konsultohuni me një Qendër të Kontrollit të Helmit.

KARAKTERISTIKA

FLUAZINOVA® PLUS është një produkt efektiv kundër kromës në mollë, njollës kafe të dardhës, kalbëzimit në hardhi si dhe vrugut në patate. Formulimi i suspensionit të koncentruar, lejon thjeshtësi të konsiderueshme në përgatitjen e përzierjes, një uniformitet të dukshëm të mbulimit të bimësisë dhe një rritje të rezistencës ndaj shpëlarjes në krahasim me formulimet tradicionale, duke bërë të mundur përdorimin e saj në koncentre të përmbajtura.

DOZAT DHE METODA E PËRDORIMIT

Sasia e treguar i referohet spërkatjes me vëllim normal (1000 litra/ha për pemët e mollës dhe dardhës, 500-1000 për hardhitë dhe 300-500 litra/ha për patatet).

Mollë

kundër kromës (*Venturia inaequalis*): ndërhyini me një dozë prej 1L/ha, në kushtet e rrezikut më të madh për sëmundjen, duke filluar ndërhyrjet në fazën e "ngjyrimit rozë të boçes", duke i përsëritur ato në intervale prej 6-10 ditësh në varësi të reshjeve, presionit të infeksionit dhe ndjeshmërisë varietale. Kur madhësia e frutave tejkalon 30 mm dhe/ose në periudha pa shi, intervali midis trajtimeve mund të zgjatet në 12-14 ditë.

Numri maksimal i trajtimeve të lejuara: 3 për vit.

Dardhë

kundër njollosjes kafe (*Stemphylium vesicarium*): ndërhyini me një dozë prej 1L/ha, në kushtet e rrezikut më të madh për sëmundjen, duke filluar ndërhyrjet në fazën e "hapjes së boçeve", duke i përsëritur ato në intervale prej 14 ditësh në varësi të reshjeve, presionit të infeksionit dhe ndjeshmërisë varietale.

Numri maksimal i trajtimeve të lejuara: 3 për vit.

Hardhi

kundër kalbëzimit (*Botrytis cinerea*): intervenoni, me një dozë prej 1L/ha, në fazat e ndjeshmërisë më të madhe të sëmundjes:

A - fundi i lulëzimit

B - para mbylljes së veshulit

C – sapo fillon faza e pjekjes

Në situata normale, dy trajtime janë të mjaftueshme në fazat kur kushtet janë më të favorshme për sëmundjen (*periudha e lagështisë relative të lartë, shi, stuhi, hiri dhe sulmet e insekteve*), duke mbajtur parasysh se në varietete me veshulë të ngjeshur, është thelbësore të kryhet trajtimi në B (para mbylljes së veshulit). Në rastin e infeksioneve veçanërisht serioze, është e këshillueshme të alternoni këtë produkt me anti-botrytik që kanë një mekanizëm të ndryshëm veprimi.

Patate

kundër kunder vrugut (*Phytophthora infestans*), me 400 ml/ha, ka një efekt të lartë dhe të pa aritshëm

nga produktet e tjera kunder vrugut të gjetes dhe tuberit. Filloni trajtimet kur ndodhin kushtet për infeksionin, normalisht kur bimët kanë arritur një lartësi prej 10-15 cm, dhe duke i përsëritur ato çdo 6-10 ditë, në varësi të reshjeve.

PËRGATITJA DHE SHPËRNDARJA E PËRZIERJES

Hidhni sasinë e rekomanduar të produktit në serbatorin e mbushur gjysmë të spërkatësit dhe përzieni mirë gjatë hedhjes. Lagni sipërfaqet e bimëve që duhen mbrojtur bollshëm dhe në mënyrë uniforme për të siguruar mbulim të përsosur.

PARALAJMËRIM:

Mos rihyni në zonën e trajtuar brenda 24 orëve nga trajtimi.

Vendosni tabela në zonën e trajtuar me shkrimin "RREZIK!": Mos hyni - zonë e trajtuar me produkte për mbrojtjen e bimëve".

PAJTUESHMERIA

Produkti përdoret i vetëm.

FITOTOKSICITETI:

Produkti mund të jetë fitotoksik për disa varietete të rrushit (Moscato dei colli, Riesling Renano, Trebbiano), kështu që është e këshillueshme, para se të kryhen aplikime në shkallë të gjerë, të kryhen teste paraprake në sipërfaqe të vogla.

KARENCA:

Ndaloni trajtimet në hardhi 21 ditë përpara vjeljes, 60 ditë për mollën dhe dhe dardhën, 7 ditë për pataten.

PARALAJMËRIM:

Të përdoret ekskluzivisht për përdorime dhe kushte specifike të raportuara në këtë etiketë. Kushdo që përdor produktin është përgjegjës për çdo dëm që rezulton nga përdorimi i papërshtatshëm të përgatitjes. Përputhja me të gjitha indikacionet e përfshira në këtë etiketë është një kusht thelbësor për të siguruar efikasitetin e trajtimit dhe për të shmangur dëmtimin e bimëve, njerëzve dhe kafshëve.

MOS E APLIKONI ME AVIACION.**MOS E NDTONI KULTURAT E TJERA, USHQIMIN DHE PIJET OSE UJERAT.****APLIKONI KUR NUK KA ERË.****MOS E SHESNI TE HAPUR.****MOS HIDHNI NE MJEDIS KONTENITORIN E BOSHATISUR.****KONTENITORI NUK MUND TË RIPERDORET.**

Nr dhe data e regjistrimit: xxxxxx

Sasia neto e PMB-se, që ndodhet në ambalazhin baze: 5 ml deri 5 lit.

Data e prodhimit:;

Data e skadencës ose periudha e ruajtjes (sipas kërkeseva të përcaktuara): 3 vjet;

Numri i partisë së mallit (serisë) ose shenja të tjera identifikuese:;

Tipi i ambalazhit baze: shishe PET, COEX ose HDPE.

Emri dhe adresa e Aplikantit: **Finchimica S.p.A., Via Lazio 13 - 25025 Manerbio (BS) (030/938901)**

Emri dhe adresa e fabrikuesit të PMB-se: **Finchimica S.p.A., Via Lazio 13 - 25025 Manerbio (BS) (030/938901)**

Emri dhe adresa e Distributorit në Shqipëri: **AGROBLEND GROUP, 1032 Vore, Tirana, Shqipëri.**

www.agroblend.com, email : info@agroblend.com tel : +355682055831, +355682055832, +355682055836

Emri dhe adresa e ambalazhuesit (kur ambalazhimi kryhet në Republikën e Shqipërisë):